


Tregtia e jashtme e mallrave

Prill 2023

Tiranë, më 18 Maj 2023: Në Prill 2023 eksportet e mallrave arritën vlerën 34 mld lekë, duke u ulur me -19,2 %, në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë dhe me -19,3 %, në krahasim me Mars 2023. Importet e mallrave arritën vlerën 75 mld lekë, duke u ulur me -3,9 %, në krahasim me një vit më parë dhe me -7,1 %, në krahasim me Mars 2023. Defiçiti tregtar i këtij muaji është 41 mld lekë, duke u rritur me 14,1 %, krahasuar me Prill 2022 dhe me 6,4 %, në krahasim me Mars 2023.

Duke qenë se Shqipëria, kryen pjesën më të madhe të shkëmbimeve tregtare me vendet e Eurozonës, zhvlerësimi i Euros ka ndikuar në volumin tregtar, krahasuar me një vit më parë. Gjithashtu, rënia e çmimeve në tregjet botërore të produkteve, që kanë impakt në volumin tregtar, ka ndikuar në treguesit e eksport/importit për muajin Prill 2023 krahasuar me një vit më parë.

Fig. 1 Ndryshimi vjetor në Tregtinë e mallrave (%)




Në këtë katërmujor eksportet e mallrave arritën vlerën 156 mld lekë, duke u ulur me -3,4 %, ndërkohë importet e mallrave arritën vlerën 283 mld lekë, duke u ulur me -0,8 %, krahasuar me një vit më parë. Defiçiti tregtar arriti vlerën 127 mld lekë, duke u rritur me 2,7 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të 2022.

Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të eksporteve:

Gjatë muajit Prill 2023, në uljen e eksporteve prej -19,2 %, kanë ndikuar grupet: “Materiale ndërtimi dhe metale” me -10,2 pikë përqindje, “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me -4,6 pikë përqindje dhe “Tekstile dhe këpucë” me -3,8 pikë përqindje. Ndërsa pozitivisht kanë ndikuar grupet: “Ushqime, pije, duhan” me +0,2 pikë përqindje dhe “Produkte kimike dhe plastike” me +0,2 pikë përqindje.

Fig.2 Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të eksporteve, Prill 2023




Eksportet, gjatë këtij katërmujori janë ulur me -3,4 %, krahasuar me një vit më parë. Grupet që kanë ndikuar negativisht në uljen vjetore të eksporteve, janë: “Materiale ndërtimi dhe metale” me -4,9 pikë përqindje, “Produkte kimike dhe plastike” me -0,5 pikë përqindje dhe “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me -0,3 pikë përqindje. Ndërsa pozitivisht kanë ndikuar grupet: “Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi” me +1,1 pikë përqindje dhe “Ushqime, pije, duhan” me +1,1 pikë përqindje.

Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të importeve:

Gjatë muajit Prill 2023, në uljen e importeve prej -3,9 %, krahasuar me Prill 2022, negativisht kanë ndikuar grupet: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me -7,7 pikë përqindje, “Tekstile dhe këpucë” me -0,9 pikë përqindje dhe “Prodhime druri dhe letre” me -0,9 pikë përqindje. Ndërsa pozitivisht kanë ndikuar grupet: “Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi” me +4,8 pikë përqindje dhe “Materiale ndërtimi dhe metale ” me +1,0 pikë përqindje.

Fig.3 Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të importeve, Prill 2023



Si katërmujor, importet janë ulur me 0,8 %, krahasuar me katërmujorin e parë 2022. Grupet që kanë ndikuar negativisht në uljen vjetore të importeve, janë: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me -4,4 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me -1,1 pikë përqindje dhe “Ushqime, pije, duhan” me -0,5 pikë përqindje. Ndërsa pozitivisht kanë ndikuar grupet: “Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi” me +4,3 pikë përqindje dhe “Produkte kimike dhe plastike” me +1,2 pikë përqindje .

Ecuria e tregtisë së mallrave sipas vendeve partnere

Në muajin Prill 2023, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur ulje më të madhe të eksporteve, në krahasim me Prill 2022 janë: Italia (16,7 %), Gjermania (48.2 %) dhe Kina (59.9 %). Ndërsa vendi me të cilin eksportet kanë pasur rritje më të madhe, është: Greqi (5,9 %), Kosova (6,1 %) dhe Spanja (285,2 %).

Gjatë këtij katërmujori vendet me të cilët Shqipëria ka pasur ulje më të madhe të eksporteve, në krahasim me një vit më parë, janë: Italia (10,6 %), Gjermania (28,9 %) dhe Kina (52,0 %). Ndërsa vendi me të cilin eksportet kanë pasur rritjen më të madhe, është: Kosova (3,3 %), Greqi (51,3 %) dhe Maqedoni (31,9 %).

Në muajin Prill 2023, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur uljen më të madhe të importeve, janë: Itali (0,2 %), Turqi (42,4 %) dhe Greqi (14,8 %). Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur rritjen më të madhe të importeve, në krahasim me Prill 2022 janë: Kina (44,0 %), Gjermani (8,8 %) dhe SHBA (161,5 %).

Gjatë këtij katërmujori, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur uljen më të madhe të importeve, në krahasim me një vit më parë, janë: Italia (2,7 %), Turqia (21,0 %) dhe Greqia (17,8 %). Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur rritjen më të madhe janë: Kina (32,3 %), Gjermani (8,1 %) dhe SHBA (75,0 %).

Fig.4 Tregtia e jashtme e mallrave sipas disa vendeve të BE-së, Prill 2023



Shkëmbimet tregtare me vendet e BE-së zënë 60,1 %, të gjithë tregtisë. Në Prill 2023, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 75,4 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 53,2 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (32,2 %), Kina (7,7 %), Greqi (6,8 %) dhe Turqi (6,7 %).

Shkëmbimet tregtare, për katërmujorin e parë 2023, me vendet e BE-së zënë 71,7 % të gjithë tregtisë. Në periudhën Janar – Prill 2023, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 74,0 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 70,0 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (36,3 %), Turqia (8,7 %), Kina (8,5 %) dhe Greqia (8,2 %).

Tab. 1 Qarkullimi i mallrave, Prill 2023

Vitet	Muajt	Eksporte (mld lekë)	Ndryshimi Vjetor (%)	Importe (mld lekë)	Ndryshimi Vjetor (%)	Bilanci Tregtar (mld lekë)	Mbulimi (%)
2000		37	-23,5	157	-1,5	-120	23,6
2001		44	19,1	190	21,0	-146	23,2
2002		47	7,7	210	10,6	-163	22,6
2003		54	14,7	226	7,4	-172	24,1
2004		62	14,0	236	4,5	-174	26,3
2005		66	6,0	262	11,1	-196	25,1
2006		77	17,6	299	14,1	-222	25,9
2007		97	25,5	376	25,8	-279	25,8
2008		113	15,8	440	16,9	-327	25,6
2009		105	-7,2	429	-2,5	-324	24,4
2010		162	54,6	478	11,4	-316	33,8
2011		197	21,9	544	13,9	-347	36,2
2012		213	8,2	528	-2,9	-315	40,3
2013		246	15,7	517	-2,1	-271	47,6
2014		256	3,8	552	6,7	-296	46,3
2015		243	-4,9	545	-1,4	-302	44,7
2016		243	0,1	579	6,4	-336	42,0
2017		273	12,1	626	8,1	-353	43,6
2018		310	13,7	641	2,4	-331	48,4
2019		299	-3,8	649	1,2	-350	46,0
2020		272	-9,0	605	-6,8	-333	44,9
2021		369	35,6	801	32,3	-432	46,1
2022		487	32,0	950	18,7	-464	51,2
2020	01 - 20	23	5,3	42	-0,4	-19	54,9
	02 - 20	25	10,6	52	3,9	-27	48,3
	03 - 20	18	-36,0	44	-20,8	-27	40,1
	04 - 20	15	-44,2	36	-36,4	-21	41,0
	Janar - Prill 20	81	-18,5	174	-15,0	-94	46,3
2021	01 - 21	24	3,1	45	8,4	-22	52,3
	02 - 21	25	-0,9	52	0,9	-27	47,4
	03 - 21	32	78,1	64	45,3	-33	49,2
	04 - 21	29	92,3	63	72,9	-34	45,6
	Janar - Prill 21	109	34,9	225	29,0	-116	48,4
2022	01 - 22	35	47,5	55	21,1	-20	63,6
	02 - 22	37	50,5	69	31,5	-31	54,3
	03 - 22	48	50,4	84	29,7	-36	57,1
	04 - 22	42	46,6	78	23,7	-36	54,0
	Janar - Prill 22	162	48,8	285	26,7	-123	56,8
2023	01 - 23	42	20,2	58	5,8	-16	72,3
	02 - 23	38	2,8	69	1,1	-31	55,2
	03 - 23	42	-11,7	81	-3,7	-38	52,3
	04 - 23	34	-19,2	75	-3,9	-41	45,4
	Janar - Prill 23	156	-3,4	283	-0,8	-127	55,3

Tab.2 Tregtia e jashtme e mallrave sipas vendeve partnere (milionë lekë), Prill 2023

	Eksporte				Importe			
	Prill 2022	Prill 2023	Jan, - Prill 2022	Jan, - Prill 2023	Prill 2022	Prill 2023	Jan, - Prill 2022	Jan, - Prill 2023
Vendet e BE-së	31.129	25.605	118.416	115.773	41.205	39.803	151.480	145.783
Austri	284	206	1.278	1.380	517	778	2.050	2.498
Gjermani	3.493	1.809	13.152	9.357	4.780	5.198	18.123	19.589
Greqi	1.884	1.994	7.554	11.432	6.378	5.433	22.419	18.423
Itali	20.112	16.756	76.014	67.925	18.267	18.233	66.309	64.493
Spanjë	290	1.116	2.128	6.773	1.158	1.058	4.588	4.185
Kroaci	1.001	458	3.050	2.269	617	524	2.267	2.071
Të tjera të BE-së	4.065	3.266	15.241	16.636	9.489	8.579	35.723	34.525
Mbretëri e Bashkuar	196	131	519	567	600	775	2.206	2.778
Kinë	1.488	597	5.257	2.521	5.404	7.780	21.476	28.407
Kosovë	2.844	3.017	12.808	13.230	1.262	808	4.741	3.490
Maqedonia e Veriut	1.224	837	6.133	8.091	1.156	1.102	4.819	4.477
Rusi	3	1	4	4	279	157	3.501	1.873
SHBA	443	276	4.066	1.539	623	1.630	3.364	5.887
Turqi	766	354	1.953	1.731	11.959	6.894	38.002	30.028
Ukrainë	28	60	206	496	140	647	1.512	1.361
Zvicër	161	124	1.196	2.219	529	461	2.584	4.454
Të tjera	3.766	2.970	11.502	10.326	14.705	14.770	51.520	54.484
Gjithsej	42.049	33.972	162.061	156.497	77.862	74.825	285.205	283.022

Tab.3 Tregtia e jashtme sipas grup mallrave (milionë lekë), Prill 2023

Grup-mallrat	Eksporte				Importe			
	Prill 2022	Prill 2023	Jan, - Prill 2022	Jan, - Prill 2023	Prill 2022	Prill 2023	Jan, - Prill 2022	Jan, - Prill 2023
Gjithsej	42.049	33.972	162.061	156.497	77.862	74.825	285.205	283.022
Ushqime, pije, duhan	4.589	4.662	15.074	16.903	11.696	11.712	44.766	43.446
Minerale, lëndë djegëse, en,el,	7.895	5.971	38.302	37.867	13.101	7.079	44.972	32.531
Produkte kimike dhe plastike	1.177	1.260	5.831	4.993	9.955	9.814	36.033	39.353
Lëkurë dhe artikujt prej tyre	227	287	986	1.106	1.712	1.456	5.871	5.153
Prodhime druri dhe letre	1.207	909	4.349	4.027	2.990	2.313	10.698	9.467
Tekstile dhe këpucë	11.999	10.422	44.434	44.713	8.888	8.211	31.697	31.476
Materiale ndërtimi dhe metale	10.614	6.311	37.180	29.199	11.449	12.225	46.334	43.267
Makineri, pajisje dhe pj, këmb,	3.333	3.138	12.040	13.777	15.187	18.957	54.634	66.881
Të tjera	1.007	1.013	3.866	3.913	2.884	3.058	10.200	11.448

Tab.4 Të dhënat progresive të eksporteve sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë (milionë lekë), Prill 2023

	Itali		Kosova		Greqi		Gjermani	
	2022	2023	2022	2023	2022	2023	2022	2023
Gjithsej	76.014	67.925	12.808	13.230	7.554	11.432	13.152	9.357
Ushqim, pije duhan	3.691	4.698	1.612	1.795	1.227	1.489	595	661
Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike	12.240	4.102	2.314	2.822	1.009	4.643	7.903	4.176
Produkte kimike dhe plastike	1.471	2.030	1.555	1.329	343	356	12	12
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	926	1.052	5	4	6	10	2	2
Prodhime druri dhe letre	2.615	2.410	469	356	647	624	107	50
Tekstile dhe këpucë	34.742	34.953	71	74	1.875	2.257	2.852	3.236
Materiale ndërtimi dhe metale	11.860	9.690	5.811	5.551	2.166	1.681	673	468
Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi	6.526	7.112	536	748	37	32	845	631
Të tjera	1.943	1.880	436	551	244	342	163	121

Tab.5 Të dhënat progresive të importeve sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë (milionë lekë), Prill 2023

	Itali		Turqi		Kinë		Gjermani	
	2022	2023	2022	2023	2022	2023	2022	2023
Gjithsej	66.309	64.493	38.002	30.028	21.476	28.407	18.123	19.589
Ushqim, pije duhan	8.657	8.291	2.204	2.070	439	603	1.933	1.979
Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike	2.509	2.244	3.206	4.629	2	15	360	329
Produkte kimike dhe plastike	7.988	8.027	3.816	4.176	2.247	2.533	4.108	3.897
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	4.787	4.184	173	131	251	239	27	23
Prodhime druri dhe letre	2.373	2.198	1.895	1.698	312	547	383	276
Tekstile dhe këpucë	15.940	15.202	5.926	4.782	3.337	3.834	802	837
Materiale ndërtimi dhe metale	8.681	9.268	15.225	7.192	2.586	3.659	552	689
Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi	12.989	12.493	3.878	3.957	10.269	14.917	9.417	10.819
Të tjera	2.385	2.586	1.680	1.392	2.033	2.061	543	740

Metodologjia

Tregtia e Jashtme e mallrave është një publikim periodik mujor që paraqet tregtinë e mallrave të Shqipërisë me vendet e tjera të botës. Të dhënat e përpunuara nga INSTAT për këtë publikim janë të dhëna administrative të cilat merren nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

Definicionet:

Eksportet janë në përgjithësi mallra të destinuara tek një vend i tretë, të vendosura nën regjimin doganor, në përpunimin pasiv ose të riekportuar pas përpunimit aktiv.

Vlera F.O.B: Është vlera e mallrave të eksportuara deri në kufirin e vendit eksportues, pra përfshin koston e mallrave të eksportuara dhe shpenzimet deri në kufi të vendit eksportues.

Importet janë në përgjithësi mallra që vinë nga një vend i tretë, të vendosura direkt në qarkullim të lirë ose që qëndrojnë në magazinat e ruajtjes nën procedurat doganore të lejimit për qarkullim të lirë, për përpunim aktiv ose për përpunim nën kontrollin doganor.

Vlera C.I.F: Është vlera e mallrave të importuara dërguar deri në kufirin e vendit importues, pra përfshin koston e mallit edhe shpenzimet e transportit dhe sigurimit deri në kufirin e vendit që importon mallrat.

Nomenklatura e Kombinuar (NK) është një nomenklaturë mallrash e përdorur për statistikat e tregtisë ndërkombëtare të mallrave dhe për tarifatat doganore.

<http://www.instat.gov.al/al/metodologji/klasifikime-nomenklatura.aspx>;

Vendet anëtare të Bashkimit Evropian: Belgjikë, Gjermani, Francë, Itali, Luksemburg, Holandë, Danimarkë, Irlandë, Greqi, Spanjë, Portugali, Austri, Finlandë, Suedi, Qipro, Çeki, Estoni, Hungari, Letoni, Lituani, Maltë, Poloni, Sllovaki, Slloveni, Bullgari, Rumani, Kroaci.

Shpjegimi i simboleve

(0) vlerë më e vogël se gjysma e njësisë matëse

(-) pa vlerë

(÷) deri